



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Komisioni për Buxhet dhe Financa

Legjislatura e III-të
Nr. 23/08
Prishtinë, më 29 .09.2008, ora 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-203

PROCESVERBAL

nga mbledhja e Komisionit për Buxhet dhe Financa

Anëtarët e pranishëm të Komisionit: Gani Koci, Kosara Nikolić, Besa Gaxherri, Safete Hadërgjonaj, Armend Zemaj, Myrvete Pantina, Xhevdet Neziraj, Hajdin Abazi, Shkumbin Demaliaj.

Anëtarët jo të pranishëm: Haki Shatri, Müfera Şinik, dhe Behxhet Pacolli.

Nga stafi mbështetës i Komisionit: Natasha Tisma-Prica, Vilson Ukaj, Dashurije Canolli.

Gjithashtu të pranishëm ishin: Ardian Zalli dhe Vërshim Hatipi nga TKPK, Drejtori i Administratës së Kuvendit të Kosovës z. Isa Neziri, monitorues nga USAID, OSCE, NDI.

Kryesues: Gani Koci, kryetar i Komisionit.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës
2. Shqyrtimi i kërkesës nr. 03/0952 /Do- 578, të datës 09.09.2008 të Trustit të Kursimeve Pensionale të Kosovës për zbritjen e tarifës menaxhuese
I ftuar: Kryesuesi i Bordit të Trustit të Kursimeve Pensionale të Kosovës
3. Shqyrtimi i Raportit të Zyrës së Auditorit Gjeneral mbi pasqyrat financiare të Kuvendit të Republikës së Kosovës për vitin 2007
4. Shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2004/48 për Administratën Tatimore dhe Procedurat, me amendamente

5. **Shqyrtimi i Projektligjit për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 2003/7 për Lëndën Arkivore dhe Arkivat me raportin e komisionit funksional - Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini e Sporte, me amendamente**
6. **Të ndryshme.**

Kryesuesi, konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e mbledhjes dhe hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryesuesi, kërkoi nga anëtarët të deklarohen për rendin e ditës.

Isa Neziri, kërkoi që pika e tretë e rendit të ditës të shtyhet për shqyrtim në mbledhjen e radhës së komisionit, për shkak të pamundësisë së pjesëmarrjes së Sekretarit të Kuvendit, i cili gjendet në udhëtim zyrtar jashtë vendit.

Armend Zemaj, u pajtua që në mungesë të Sekretarit, pika e tretë e rendit të ditës të shtyhet për në mbledhjen e radhës.

Safete Hadërgjonaj, gjithashtu u pajtua që në mungesë të Sekretarit të Kuvendit, pika e tretë e rendit të ditës të shtyhet për shqyrtim në mbledhjen e radhës.

Besa Gaxherri, duke u ndërlidhur me diskutimet e parafolësve, theksoi se pasi që e kemi materialin të kompletuar lidhur me pikën e tretë të rendit të ditës dhe e kemi marrë me kohë, të shqyrtohet në këtë mbledhje dhe Komisioni të nxjerr rekomandimet për Kuvend.

Kryesuesi, duke u ndërlidhur me propozimet për shtyrje apo shqyrtim të pikës së tretë të rendit të ditës, u pajtua që për shkak të mungesës së Sekretarit të Kuvendit, kjo pikë të shtyhet për në mbledhjen e radhës së komisionit. Në vazhdim kërkoi nga anëtarët të deklarohen për shtyrjen e pikës së tretë për në mbledhjen e radhës së Komisionit

Pas vërejtjeve dhe propozimeve, me votimin e bërë, Kryesuesi konstatoi se me nëntë vota PËR dhe asnjë KUNDËR Komisioni nxori këtë:

Q ë n d r i m

Pika e tretë e rendit të ditës - Shqyrtimi i Raportit të Zyrës së Auditorit Gjeneral mbi pasqyrat financiare të Kuvendit të Republikës së Kosovës për vitin 2007, shtyhet për shqyrtim për në mbledhjen e radhës së komisionit.

2. **Shqyrtimi i kërkesës nr. 03/0952 /Do- 578, të datës 09.09.2008 të Trustit të Kursimeve Pensionale të Kosovës për zbritjen e tarifës menaxhuese**
I ftuar: Kryesuesi i Bordit të Trustit të Kursimeve Pensionale të Kosovës

Kryesuesi, kërkoi nga përfaqësuesit e TKPK-së sqarime lidhur me vendimin e Trustit për zbritjen e tarifës menaxhuese.

Ardian Zalli, njoftoi për aktivitetin dhe financimin e këtyre aktiviteteve të TKPK-së. Sipas tij buxheti i TKPK-së financohet prej tarifës menaxhuese. Duke pasur parasysh faktin se asetet e TKPK-së janë rritur, është marrë vendim për zbritjen e taksës menaxhuese për 10 % në mënyrë që kontribuuesit e të jenë më

pak të ngarkuar me pagesat për financimin e shpenzimeve të TKPK-së. Përndryshe për aktivitetin e trustit dhe bashkëpunimin e tij me Komsioni, z. Zalli propozoi të organizohet një work shop.

Myrvete Pantina, vlerësoi pozitivisht vendimin e trustit për zbritjen e tarifës menaxhuese, i cili shkon në favor të kontribuesve pensional. Në vazhdim parashtrij dy pyetje:

- A ekziston ndonjë lidhmëri ndërmjet humbjeve në aksione dhe taksës menaxhuese.
- Sa përqind ka ndikuar në humbjen e mjeteve të trustit, si rezultat i humbjeve nga aksioneve të trustit.

Xhevdet Neziraj, theksoi se kursimtarët kanë pak njohur se çfarë bëhet me mjetet e tyre të investuara jashtë vendit. Andaj pyeti sa ka mundësi që këto mjete fondi të i kthej në tregun financiar të Kosovës, kur dihet fakti se aq shumë tregu vendor ka nevojë për këto mjete financiare.

Besa Gaxherri, duke u komentuar humbjet që ka pasur TKPK-ja, pyeti sa keni siguri që këto humbje të mos rriten. U pajtua se Ligji pamundëson që mjetet e trustit në një shumë më të madhe të investohen në tregun e vendit. Andaj pyeti se keni shikuar Ligjin , ndonjë nen apo dispozitë që ka nevojë të ndryshohet, në mënyrë që krijohet mundësia ligjore, që paratë e kursimtarëve të Kosovës, të kthehen për t'u investuar në tregun vendor.

Kryesuesi, kërkoi nga anëtarët që në diskutimet e tyre të përqendrohen në kërkesën për zbritjen e taksës menaxhuese. Ndërsa për problemet tjera të TKPK-së dhe mardhëniet e tij me Komisionin, u pajtua që të organizohet një takim i përbashkët.

Safete Hadërgjonaj, u pajtua me kërkesën për zbritjen e tarifës menaxhuese, sepse kjo shkon në dobi të kontribuesve të fondit. Znj. Hadërgjonaj theksoi se deri më tani, Komisioni nuk ka pasur informacione zyrtare për punën e trustit. Mirëpo me ndryshimin e rrethanave janë krijuar kushtet për një bashkëpunim të këtyllë. Prandaj në këtë kontekst u pajtua me propozimin për organizimin e work shopit. Kërkoi që bashkëpunimi të vazhdoi në mënyrë të vazhdueshme, me qëllim që të ndikohet në menaxhimin më të mirë të mjeteve të trustit dhe të punohet ë[që këto mjete të investohen në tregun financiar të vendit.

Vërshim Hatipi, duke i përgjigjur pyetjeve për humbjen e mjeteve të trustit, theksoi se nga këto humbje, zbritja ka ndodhur për 0.10 % nga 1.00% sa ka qenë në 0.90%.

Ardian Zalli, duke i përgjigjur pyetjes së znj. Pantina, theksoi se deri në fund të vitit 2007 ka pasur fitim, ndërsa humbjet kanë ndodhur gjatë vitit 2008 si rezultat i problemeve financiare globale. Korrelacioni në mes humbjeve dhe taksës menaxhuese është i vogël. Ndërsa në pyetjet lidhur me investimin mjeteve në tregun vendor theksoi se Ligji në fuqi i'a pamundëson që mjetet e trustit të investohen në tregun bankar më shumë së 5%. Prandaj në përpjekjet në këtë drejtim do të ndikonte krijimi dhe zhvillimi i tregut të kapitali, ku trustit do t'i mundësohej të investon në letrat me vlerë që i lëshon qeveria, që do të ishin të sigurta. Në këtë mënyrë mjetet këto mjete do të investoheshin në tregun vendor.

Pas vërejtjeve dhe propozimeve, me votimin e bërë, Kryesuesi konstatoi se me nëntë vota PËR dhe asnjë KUNDËR, Komisioni nxori këtë:

R E K O M A N D I M

- I. Miratohet kërkesa nr. 03/0952 /Do- 578, e datës 09.09.2008 të Trustit të Kursimeve Pensionale të Kosovës për zbritjen e tarifës menaxhuese
- II. Komisioni i propozon Kryesisë së Kuvendit ta radhis në rend dite për shqyrtim në seancën plenare të radhës.

3. Shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2004/48 për Administratën Tatimore dhe Procedurat, me amendamente

Kryesuesi, njoftoi për përgatitjen e amendamenteve të grupit punues lidhur me projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2004/48 për Administratën Tatimore dhe Procedurat. Lidhur me këtë kërkoi sqarime të mëtutjeshme nga kryesuesi i grupit punues, z. Zemaj.

Armend Zemaj, theksoi se grupi punues pas takimeve që ka pasur së bashku me ekspertët e USAID dhe përfaqësuesin e Administratës Tatimore, kanë harmonizuar qëndrimet dhe janë përgatitur amendamentet e gatshme. Mirëpo lidhur me shkrimin e amendamenteve tha se janë bërë ca gabime teknike, të cilat i evidentojë, si të shtohet një amendament i ri nga neni 46.5 i Ligjit.

Pas vërejtjeve dhe propozimeve, me votimin e bërë, Kryesuesi konstatoi se me nëntë vota PËR dhe asnjë KUNDËR Komisioni nxori këtë:

R E K O M A N D I M

- I. Miratohen Amendamentet e propozuara nga grupi punues lidhur me Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2004/48 për Administratën Tatimore dhe Procedurat dhe i rekomandohet Kryesisë së Kuvendit projektligjin me amendamente ta radhis në rend dite për shqyrtim në seancën plenare

4. Shqyrtimi i Projektligjit për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 2003/7 për Lëndën Arkivore dhe Arkivat me raportin e komisionit funksional - Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini e Sporte, me amendamente

Kryesuesi, se Projektligji dhe amendamentet e komisionit funksional nuk përmbajnë implikime buxhetore dhe si të tillë kërkoi që ta miratojnë

Me votimin e bërë, Kryesuesi konstatoi se me nëntë vota PËR dhe asnjë KUNDËR Komisioni nxori këtë:

R E K O M A N D I M

- I. Komisioni për Buxhet dhe Financa ka shqyrtuar Projektligjit për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 2003/7 për Lëndën Arkivore dhe Arkivat dhe ka konstatuar se dispozitat e të njëjtit nuk përmbajnë implikime buxhetore.
- II. Komisioni për Buxhet dhe Financa, ka shqyrtuar Raportin me amendamentet e Komisionit Funksional – Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji Kulturë, Rini e Sporte, me amendamente dhe ka konstatuar se amendamentet e propozuar nuk përmbajnë implikime buxhetore dhe i rekomandon Kuvendit që të miratojë Projektligjin me amendamentet e propozuara.

7. Të ndryshme

Kryesuesi, njoftoi për marrjen e materialit të Komisionit për përzgjedhje, i cili propozim ishte bërë në kohën TKPK-ja ka qenë nën kompetenca të PSSP-së.

Besa Gaxherri, theksoi se janë shkelur procedurat rreth propozimit të anëtarëve për emërim në bord. Nuk është përfillur ligji rreth propozimit të kandidatëve nga Komisioni për përzgjedhje. Në veçanti bëri vërejtje për propozimin e anëtarëve ndërkombëtar.

Hajdin Abazi, përkujtoi arsyen e mosvotimit të kësaj kërkesë, për shkak të mungesës së informacionet rreth procedurës për përzgjedhje të kandidatëve. Tani kur e kemi para vetit, ajo çka mund të bëjmë është që mund të japim vërejtje ndaj ndonjë kandidati. Përndryshe nuk ka arsye për shtyrje.

Shkumbin Demaliaj, theksoi se nga anëtarët shifet se pjesëmarrja është jo e barabartë që është edhe në kundërshtim me Ligjin, i cili thotë se tre duhet t'ë jenë ndërkombëtar e tre tjerë vendorë . ndërsa në propozim shohim se janë katër ndërkombëtar (duke përfshirë edhe znj. Mimoza Kusari si përfaqësuese e Odës Ekonomike Amerikane).

Myrvete Pantina, lidhur me kontestimin e znj. Kusari për anëtare të bordit për shkak se përfaqëson një organizatë biznesore ndërkombëtare, theksoi se Oda Ekonomike Amerikane përfaqëson të gjithë punëmarrësit në Kosovë. Arsye e kandidimit të përfaqësueses nga OE, është si rezultat i asaj se në të kaluarën në bord një herë ka qenë përfaqësuesi i OEK, një herë përfaqësuesi i AKB, ndërsa tani ma marrëveshje është propozuar përfaqësuesja e OEA.

Haxhi Gashi, shpjegoi se ligjet e reja nuk do të thotë se shpërfillin ato të vjetrat. Nga materiali shifet se kandidatët janë zgjedhur me konkurs, gjë që dëshmon se është respektuar ligji.

Xhevdet Neziraj, pas marrjes së materialit me sqarime, kërkoi që komisioni të rekomandoj për kalim në seancë plenare dhe atje të merret vendimi për kandidatët e propozuar.

Safete Hadërgjonaj, pasi që janë respektuar procedurat e propozimit të kandidatëve, kërkoi që komisioni të rekomandojë për kalim në seancë plenare dhe atje secili mund të shpreh mendimin e vet. Lidhur me kontestimin e znj. Kusari tha se nuk është në dijeni se është anëtare e ndonjë partie politike, por se ajo përfaqëson një asociacion biznesi e cila mbron interesat e të gjithë bizneseve në Kosovë.

Kosara Nikolić, u ankua për shkak të mosmarrjes së materialeve në gjuhën serbe, dhe kjo po ndodh pothuajse për çdo takim që kemi. Prandaj si rezultat i kësaj theksoi se nuk po ka mundësi të i lexojë materialet, dhe në këtë formë nuk po mundem të përgatitem për diskutim.

Kryesuesi, duke u ndërlidhur me komentimet, theksoi se procedura ligjore është respektuar, por është vonuar sikurse edhe shumë çështje tjera që kanë filluar para 15 Qershorit. Në vazhdim hodhi në votim këtë propozim.

Pas vërejtjeve dhe propozimeve, me votimin e bërë, Kryesuesi konstatoi se me pesë vota PËR dhe katër KUNDËR (znj. Besa Gaxherri, z. Shkumbin Demaliaj, z. Xhevdet Neziraj dhe z. Armend Zemaj) Komisioni nxori këtë:

R E K O M A N D I M

- I. Komisioni shqyrtoi propozimin e Komisionit për përzgjedhje të datës 15-18 Mars 2008 me vendimin nr.02/04, dt.03.09.2008 të Qeverisë së Republikës së Kosovës për emërimin e kandidatëve për anëtarë të Bordit të Trustit Pensional të Kosovës dhe me shumicë votash i rekomandon Kryesisë së Kuvendit ta radhis në rend dite për shqyrtim në seancën plenare të radhës

Kryesuesi, njoftoi anëtarët se pas kërkesës së bërë MEF-i për dorëzimin e deklaratës financiare për Projektligjin për Ansamblin Kombëtar të Këngëve dhe Valleve “Shota” dhe për Ansamblet tjera, është

kthyer përgjigja dhe nga vlerësimi shifet se Projektligji me amendamentet e komisionit funksional nuk përmbajnë implikime buxhetore, prandaj kërkoi ta miratojnë atë.

Me votimin e bërë, Kryesuesi konstatoi se me nëntë vota PËR dhe asnjë KUNDËR, Komisioni nxori këtë:

R E K O M A N D I M

- II. Komisioni për Buxhet dhe Financa ka shqyrtuar Projektligjin për Ansamblin Kombëtar të Këngëve dhe Valleve “Shota” dhe për Ansamblet dhe ka konstatuar se dispozitat e të njëjtit nuk përmbajnë implikime buxhetore.

- II. Komisioni për Buxhet dhe Financa, ka shqyrtuar Raportin me amendamentet e Komisionit Funksional – Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji Kulturë, Rini e Sporte, me amendamente dhe ka konstatuar se amendamentet e propozuar nuk përmbajnë implikime buxhetore dhe i rekomandon Kuvendit që të miratojë Projektligjin me amendamentet e propozuara.

Mbledhja përfundoi në ora 12:30

Përgatitur nga
Njësia për mbështetjen e Komisionit

Kryesuesi i Komisionit

Gani KOCI